



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMUNA E PRIZRENIT  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

**DREJTORIA E  
KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

**RAPORTI I PUNËS**  
për periudhën janar - dhjetor 2018

**Prizren, 2018**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMUNA E PRIZRENIT  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit, tel. 44 748

## Raport i punës, për periudhën janar - dhjetor 2018

Gjatë kësaj periudhe, DKRS ka pranuar mbi 200 kërkesa nga subjekte të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive, të cilat kryesisht kërkojnë mbështetje materiale, sigurimin e transportit apo edhe sigurimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Prizrenit.

DKRS, për vitin 2018 për investime kapitale ka pasur një buxhet prej 1.170.000 €, për subvencione, 130.000.00, kurse për mallra dhe shërbime 7.000.00 €

DKRS, në vitin 2018 ka pritur në takime pune shumë palë nga subjekte të ndryshme nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit të interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre gjatë vitit 2018.

Janë vizituar objektet ku janë duke u zhvilluar punimet në realizimin e projekteve kapitale, sikurse që janë: Stadiumi i qytetit në Prizren, Stadiumi në Sërbicë, Shtëpia e Kulturës në Zhur, Stadiumi i në Zhur. Ndërtimi i sallës sportive ne SHF Fadil Hisari, ndërtimi i tereni sportiv ne Piranë, Medvec, Ndërtimi i shtegut të atletikës në Boka – Korishë, Ndërtimi terreneve sportive në Prizren, Ndërtimi i i Pishinës Olimpikë në Prizren etj.

**Është** realizuar vendimit të Kryetarit të Komunës për subvencionimin e subjekteve kulturore, rinore e sportive të Komunës së Prizrenit. Me këto subjekte janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit, pastaj janë përcjellë aktivitetet dhe realizimi i projekteve të subvencionuara. Krahas kësaj janë zhvilluar edhe takime pune me MKRS-në, lidhur me projektet të cilat kjo Ministri ka paraparë të investoj në Prizren gjatë vitit 2018. Janë zhvilluar takime pune me përfaqësuesit e fshatrave, janë evidentuar lokacionet dhe është punuar në nxjerrjen e dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e punimeve në këto projekte.



Ndërtimi i tribunave të stadiumit të qytetit



Ndërtimi i stadiumit në Zhur

### **Përvjetori i 10-të, i Pavarësisë së Kosovës,**

Më 17.02.2018 në Prizren janë mbajtur manifestimet kulturore, kushtuar 17 shkurtit – Dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Në Kuadër të këtyre manifestimeve janë organizuar një varg aktivitete: Pothuajse gjatë dy javëve të fundit duke filluar nga data 01.02.2018, DKRS aktivisht është marrë me organizimin dhe përpilimin e agjendës së shënimit të përvjetorit të 10-të, të Pavarësisë së Kosovës. Në përpilimin e kësaj agjende kontribut kanë dhënë edhe Komisioni për shënimin e përvjetorit të 10-të, të Pavarësisë së Kosovës të cilin e ka formuar Kryetari i Kmunës, Z. Mytahir Haskuka. Në agjendë janë përfshirë kryesisht aktivitete kulturore, letrare, muzikore e sportive. Aktivitetet për shënimin e përvjetorit të 10-të, të Pavarësisë së Kosovës, kanë filluar nga data 15 dhe kanë përfunduar më 18 shkurt 2018.

**Më 15.02.2018** - Me rastin e shënimit të 10-të vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, është mbajtur Aktiviteti i fëmijëve parashkollor me qerdhet e fëmijëve të Komunës së Prizrenit aktiviteti ka vazhduar me korin e fëmijëve «Yjet» që ka performuar me fëmijët e moshës 7 -12 vjeç në SHK «XH. Berisha» në Prizren.

**Më 16.02.2018** - është mbajtur ora letrare «Urime ditëlindjen Kosovë» me poetët e rinj nxënës të shkollave të mesme të Komunës së Prizrenit. Ora letrare është begatuar me tri pika muzikore të interpretuara nga nxënësit e SHM «Lorenc Antoni» nga Prizreni.

Aktivitetet kanë vazhduar me ekspozitën dhe reportazhin e 10 vjetorit të Pavarësisë të përgatitur nga vullnetarët e bibliotekës, më pas vullnetarët e bibliotekës, nga shtëpia e kulturës «Xhemajli Berisha» janë nisur drejtë kalasë. Ku edhe atje kanë performuar dhe kanë dëgjuar muzikë. Në mbrëmje në orën 19.00 në shkollën e muzikës « Lorenc Antoni » arsimtarët e kësaj shkolle kanë dhënë një koncert me muzikë klasike, ndërsa në ora 20:30 në Shtëpinë e Kulturës « Xhemajli Berisha » SHKA « AGIMI » ka dhënë një koncert mjaft të mirë.

**Më 17.02.2018** - në Sheshin e Lidhjes është mbajtur një koncert me bendet e të rinjve të Komunës së Prizrenit, koncerti ishte mjaft atraktiv dhe përcillej nga një numër jashtëzakonisht i madh i qytetarëve. Gjithashtu është mbajtur Koncerti i pavarësisë me SHKA-të, e Komunës së Prizrenit në një program artistik mbi 2 orë, qytetarët prizrenas koncertin e pritën me mjaft interesim. Performuan: SHKA Muharrem dhe Xhevat Qena nga Romaja, Podgorski Biser nga Gërqari, Lidhjae Prizrenit nga Prizreni, Dogry Yol nga Prizreni, Emin Duraku nga Zhuri, Durmish Asllano nga Prizreni dhe Agimi nga Prizreni. Ndërsa në orën 20:30 Teatri profesionist i qytetit ka performuar me dramën «Armiku i Popullit».

**Më 17.02.2018** - është mbajtur takimi debatues për problemet e të rinjve, ku pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e të rinjve të gjitha partive politike dhe organizatave tjera rinore të Komunës së Prizrenit.

**Më 18.02.2018** – Banda muzikore Amerikane, ka mbajtur një koncert për qytetarët e Prizrenit, dhe janë ndarë tejet të kënaqur me interesimin e qytetarëve.

**Më 23.02.2018** – Pas shqyrtimit të faturave dhe në konsultim me Kryetarin e Komunës, janë bërë pagesat e kështit të fundit të faturave të projektit: Politikat Zhvillimore të Kulturës, Rinisë dhe Sportit (konkretisht për KF Liria në shumë prej 79,900.00 €, KB Bashkimi – M, në shumë prej 81,950.00 €, dhe Teatrit Profesionist në shumë prej 38,750.00 €, gjithashtu janë përcjell aktivitetet dhe veprimtarinë e këtyre organizmave.



Çaste nga aktivitetet e Pavarësisë së Kosovës



Çaste nga koncerti i Pavarësisë së Kosovës



**Më 07.03.2018** – Për herë të parë është aplikuar thirrja publike për subvencionim nga ana e Komunës së Prizrenit, kjo formë e aplikimit është përkrahur nga opinioni i gjerë prizrenas, meqë ofron mundësi për të gjithë dhe transparencë maksimale. Gjithashtu janë formuar edhe komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve. Komisioni për Kulturë dhe Rini përbëhet nga 5 anëtarë sikurse edhe Komisioni për Sport që ka 5 anëtarë.

**Më 08.03.2018** – Për nder të 8 Marsit, në Sheshin Shadërvan është organizuar gara automobilistike për femra. Kjo garë është organizuar në bashkëpunim me Klubin e automobilizimit “Prizreni D&G” nga Prizreni. Interesimi i për këtë garë ishte mjaft i madh kishte garuese edhe nga vendet e rajonit.

**Më 05.04.2018** – Është mbajtur debati me komunitetin e biznesit dhe të sportit lidhur me Ligjin për sponsorim. Në takim kanë marrë pjesë një numër mjaft i madh i të interesuarave, nga subjektet kulturore, rinore dhe sportive, përfaqësues të biznesit, si dhe shumë të tjerë. Në takim ka marrë pjesë edhe Ministri i KRS-së, Z. Kujtim Gashi, Drejtori i DKRS-së Ehat Oreshka etj.

**Më 11.04.2018** – Është mbajtur java e bibliotekës. Ku janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve kulturore e letrare.

**Më 22.04.2018**, është organizuar dita e tokës, në kuadër të sajë është zhvilluar një defile me biçikleta, nga të rinjtë prizrenas, ku kanë marrë pjesë mbi 100 pjesëmarrës, ngasës me biçikleta për ta shënuar këtë aktivitet. Pjesëmarrësit kanë qenë të moshave të ndryshme nga nxënësit e shkollave fillore e deri te veteranët, poashtu pjesëmarrës kanë qenë edhe familjarë.

**Më 25.04.2018** është mbajtur takimi sensibilizues i Ligjit për sponsorim të Kosovës me bizneset dhe subjektet e ndryshme nga sporti e kultura, ku ndër të tjerë ka marrë pjesë Drejtori i DKRS-së, Ministri i KRS-së, si dhe personalitete tjera. Takimi është mbajtur në sallën e kuqe të Komunës së Prizrenit,

**Më 13.05.2018** – Klubi i Tekwondosë “Prizreni” ka organizuar një aktivitet promovues tejet interesant në “kej” ku kanë performuar nxënësit dhe aktivistët e këtij klubi para publikut prizrenas.

**Më 13.05.2018** Është mbajtur festivali i muzikës për fëmijë “Vallëzo Prizren 2018”, organizuar në Kompleksin e Lidhjes së Prizrenit, ku artistët e vegjël me mjeshtri kanë performuar para publikut prizrenas.

**Më 25.05.2018** - Në bashkëpunim me KOK-un, në Prizren është organizuar Vrapimi i Pavarësisë me nxënësit e shkollave fillore (fëmijët e lindur më 2008) – Këtë aktivitet e kanë përkrahur edhe DA duke siguruar pjesëmarrësit (nxënësit dhe arsimtarët e edukimit fizik) për vrapim. Vrapimit ka filluar në ora 10.00 para “Shtëpisë së Bardhë” dhe ka përfunduar në Sheshin “Shatërvan”. Më të mirët janë nderuar me medalje.



Çast nga vrapimi i Pavarësisë në Prizren

**Më 10-12.06.2018** – Janë mbajtur manifestimet kushtuar festave të qershorit, 10 Qershorit – Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (140 vjetorit) dhe 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Prizreni. Në këtë manifestim ka pasur aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive .

**Më 20.07.2018** në Palestrën Sportive “Sezai Surroi”, në Prizren është zhvilluar ceremonia e vënies së gur-themelit të projektit: Ndërtimi i Pishinës Olimpike. Ku ndër të tjerë pjesëmarrës kanë qenë edhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, Kryetari i Komunës Prof.Dr. Mytaher Haskuka, Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport Z. Ehat Oreshka, si dhe zyrtarë dhe personalitete të tjera. Projekti ka një kosto prej 2 milion e gjysmë euro.

**Më 30.10.2018** – Në Zhur është zhvilluar ceremonia zyrtare e vënies së gur-themelit në ndërtimin e stadiumit në Zhur, ku ndër të tjerë, kanë marrë pjesë edhe Ministri i MKRS-së, Z. Kujtim Gashi, Kryetari i Komunës Z. Mytaher Haskuka, Kryesuaesi i Kuvendit të Komunës Z. Artan Abrashi, Nën Kryetari i Komunës Z. Eshref Ademaj, Asamblistë të Komunës së Prizrenit, Drejtorë, pjesëtar të komunitetit si dhe personalitete të tjera.

Më 22,10,2018 – Është organizuar takimi me komisionin organizativ rreth organizimit të manifestimit për nderë të festës së 28 Nëntorit.

Më 25.10.2018 – DKRS është autorizuar dhe obliguar nga Komiteti për Politika dhe Financa i Kuvendit Komunal Prizrenit të merret me problematikën e stadiumit të “Koritnikut” – Arbanë, rregullimin e dokumentacionit të fushës së futbollit në Arbanë.

Më 26.10.2018 – DKRS-së, për nevoja të veta ka marrë në shfrytëzim një veturë Reno Megan.

**Më 29.10.2018** është mbajtur takimi i punës me këshillin organizativ për organizimin e Festivalit tradicional “Zambaku i Prizrenit”, në të cilin takim kanë marrë pjesë përfaqësues nga DKRS, SHKA “Agimi”, Shkolla e Muzikës, RROK, dhe Komuniteti i Artistëve. Në këtë takim është zgjedhur edhe Kryetari i Këshillit organizativ Z. Fikrim Emra si dhe Drejtori Artistik Z. Besim Berisha, ndërsa Sekretar u zgjodh Z. Festim Bytyçi. KO u dakordua që takimi radhës të jetë më i organizuar dhe të përpilohet një program i detajuar lidhur me festivalin.

**Më 27.11.2018** në shkollën ShFMU “Fadil Hisari”. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, Skender Susuri, drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ehat Oreshka dhe zyrtarë të tjerë komunalë, përuan sallën e re të edukatës fizike në shkollën ShFMU “Fadil Hisari”. Me rastin e përuimit dhe për nder të festës së 28 Nëntorit, u organizua edhe një program festiv nga nxënësit e kësaj shkolle.



Nga ceremonia e përuimit të sallës sportive në SHFMU Fadil Hisari në Prizren



Nga ceremonia e vënies së gurthemelit në fillimin e punimeve të ndërtimit të tereneve sportive në lagjen 11 Marsi në Prizren

Shënimi i 28 Nëntorit 2018, është formuar këshilli organizativ për shënimin e manifestimit të 28 Nëntorit, Më 27.11.2018 në lagjen 11 Marsi në Prizren (te shkolla fillore Lekë Dukagjini), është zhvilluar ceremonia zyrtare e vënies së gur-themelit në realizimin e projektit: Ndërtimi i terrenit sportiv në lagjen 11 Marsi, ku ndër të tjerë pjesëmarrës kanë qenë edhe Kryetari i Komunës Prof.Dr. Mytahir Haskuka, Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport Z. Ehat Oreshka, si dhe zyrtarë dhe personalitete të tjera. Më 28.11.2018 në kino Lumbardhi u shfaq filmi dokumentar kushtuar shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Ky manifestim u përcjell nga shumë fëmijë në dy termine, në terminin e parë mori pjesë dhe Kryetari i Komunës Z. Mytahir Haskuka. Në ora 14:00 në shtëpinë e kulturës “Xhemajli Berisha” në bashkëpunim me shoqatën bamirëse “Jetimat e Ballkanit” u dhuruan 28 shtëpijë për familjet me nevojë dhe në këtë manifestim mori pjesë edhe Kryetari i Komunës Z. Mytahir Haskuka dhe shumë personalitete tjerë. Në orën 17:00 në hollin e shtëpisë së kulturës “Xhemajli Berisha” u mbajt ekspozita e artistës nga Prizreni Luljeta Goranci me temë Retrospektivë nga veprimtaria ndër vite . Në ora 20:00 në shtëpisë së kulturës “Xhemajli Berisha” u mbajt mbrëmja koncertale, performues në këtë mbrëmje ishin Siparantum Choir, Wind Ensemble, Frida Toçi dhe Ilirijana Rekathati. Sipas të pranishmëve koncerti ishte në nivelin e duhur ku me performancën e artistëve duartrokitjet ishin frenetike e të pandalshme. Në 22:00 në Kino Lumbardhi është mbajtur koncerti për të rinjë nën performancën e Dren Abazit dhe Zig Zag Orchestrës. Ky koncert është ndjekur me interesim të madh nga publiku, sidomos nga të rinjtë që ishin të shumtë në numër.

Më 19.12.2018 Së bashku me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale është mbajtur një takim pune në Hotel “OK” në Prizren. Ku temë e takimit ka qenë sfidat dhe realizimi i buxhetit dhe investimet kapitale për vitin 2018 si dhe Plani i veprimit për vitin 2019. Në takim mori pjesë edhe Këshilltarja e Kryetarit Zonjusha Krenare Koqi. Secila Drejtori paraqiti të arriturat dhe problemet me të cilat janë ballafaquar Drejtoritë gjatë vitit 2018. Po ashtu janë pasqyruar edhe planet e veprimit për vitin 2019.

Më 21.12.2018 Në SHK “Xhemajli Berisha” në Prizren është mbajtur ceremonia e laureatëve të vitit, ku ndër të tjerë të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës Z. Mytahir Haskuka, Drejtori i DKRS-së Z. Ehat Oreshka, Anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, si dhe personalitete tjera. IP “Sfinga” shumë mirë e kishte organizuar këtë ceremoni. IP, kishte përgatitur fotografi të ndryshme ku përmes projektorit ato shfaqeshin dhe të pranishmit me kureshtje i përcillnin. Moderatorët pasi pasqyruan punën që komisionet përkatëse nga kultura-rinia dhe sporti kishin bërë, ftuan që Drejtori i DKRS-së Z.Ehat Oreshka t’i ndajë mirënjohjet për laureatët. Ndërsa laureatit – sportistit më të dalluar – Mentor Ajazaj (atlet), mirënjohjen ia



Nga aktiviteti i të rinjëve të Prizrenit



Të rinjtë prizrenas gjatë një aktiviteti në Prizren



Nga ceremonia e laureatëve të vitit në SHK “Xhemajli Berisha” në Prizren

ndau Kryetari i Komunës, Z. Mytahir Haskuka i cili me këtë rast edhe i uroi të gjithë të pranishmit e në veçanti laureatët e vitit. Pas ceremonisë për të pranishmit ishte përgatitur një koktej rasti.

Gjatë muajve prill dhe maj 2018 në bashkëpunim me organizatën rinore **ipsia** është bërë “Vlerësimi mbi nevojat e të rinjëve” në Komunën e Prizrenit. Ky dokument ofron të dhëna të cilat mund të shërbejnë në identifikimin e nevojave dhe interesave të të rinjve të Komunës së Prizrenit dhe në të njëjtën kohë ju ofron organizatave rinore dhe të tjerëve materiale për nevojat e këtyre të rinjve.

### PER PROJKTET KAPITALE - 2018

Nr.	Kodi	DREJTORIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT	2018		
			TG	THV	GJ TH
1	85519	Hartimi i projekteve (Hartimi dhe mbikëqyrja) e projekteve	0	10,000	10,000
2	85524	Ndërtimi i tereneve sportive - në Medvec	0	20,000	20,000
3	85528	Renovimi dhe mirëmb. e objekt. ekzistuese kulturore sportive	0	20,000	20,000
4	87783	Ndërtimi i terenit sportiv në Sërbicë të poshtme.	80,000	0	80,000
5	87787	Organizimi i festivaleve tradicionale	0	30,000	30,000
6	40726	Ndërtimi i Bibliotekës regjionale ne Prizren	100,000	50,000	150,000
7	40729	Inventarizimi i objekteve ekzistuese	0	10,000	10,000
8	40730	Projekti laureatët e vitit	0	10,000	10,000
9	40731	Furnizimi me rekuizita	0	10,000	10,000
10	40733	Ndërtimi i Qendrës kulturore në Krushë të Vogël	0	50,000	50,000
11	43428	Rregullimi i tribunave të stadiumit të qytetit	100,000	0	100,000
12	43434	Rregullimi i ambjentit te qendrave kulturore	0	20,000	20,000
13	43435	Projekti manifestimet e qershorit	40,000	0	40,000
14	43437	Projekti botimi i librave te rinj	0	10,000	10,000
15	45141	Ndërtimi i salles sportive ne SHMU Fadil Hisari – Prizren	0	20,000	20,000
16	46685	Ndërtimi i tereneve sportive	50,000	0	50,000
17	46689	Ndërtimi i shtegut të atletikës	50,000	0	50,000
18	46690	Ndërtimi i tereneve sportive ne Pirane	0	20,000	20,000
19	46692	Ndërtimi i QKS ne Nashec	0	20,000	20,000
20	46693	Ndërtimi i stadiumit në Sërbicë	50,000	0	50,000
21	46695	Ndërtimi i QK turke ne Prizren	0	20,000	20,000
22	46758	Projekti politikat zhvillimore të kulturës, rinisë dhe sportit	240,000	140,000	380,000
			710,000	460,000	1,170,000

### TEATRI I QYTETIT "EKIM FEHMIU" - PRIZREN Aktivitetet gjatë vitit 2018

1. Me 17 janar 2018 repriza “Armiku i Popullit” – Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
2. Me 27 janar 2018 shfaqja mysafiret nga Tirana - Rojat e Taxhit prodhim i Teatrit Eksperimental te Tiranës “Kujtim Spahivogli” ne bashkëpunim me “Bash Art” –Tirane.
3. Me 28 janar 2018 repriza “Armiku i Popullit” – Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
4. Me 09 Mars 2018 jepet repriza e shfaqjes “Ata Qe Ikin”- Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Aktivitet humanitar, ku paratë e mbledhura nga biletat e shfaqjes janë dedikuar per regjisorin tani më të ndjere Bekim Lumi.



5. Me 27 Mars 2018 ne Diten Nderkombetare te Teatrit Ministria e Kultures se Republikes se Kosoves i ndane çmimin “Shfaqja me e mire per vitin 2017” per shfaqjen “Ata qe Ikin” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren, si dhe çmimin per Regjine me te mire, regjisorit te njohur Kushtrim Bekteshi që ishte regjisor i kesaj shfaqje.
6. Me 04 Maj 2018 jepet premiera e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
7. Me 05 Maj 2018 jepet repriza e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
8. Me 08 Qershor 2018 jepet repriza e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Per nder te 140 vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit.
9. Me 09 Qershor 2018 jepet repriza e shfaqjes “Ata Qe Ikin”- Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Per nder te 140 vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit.
10. Me 13 Qershor ne Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren, jepet Monodrama “Aktori ne Kuti” nga Aktori I njohur Mentor zymberi. Per nder te 140 vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit.
11. Me 08 Korrik 2018 shfaqet Premiera “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
12. Me 09 Korrik 2018, jepet repriza e shfaqjes “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
13. Me 27 Korrik 2018 jepet repriza e shfaqjes “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren, per nder te bashkeatdhetareve tane ne diaspore.
14. Me 01 Shtator 2018 jeper repriza e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
15. Me 04 Shtator 2018 Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”- Prizren merr pjese ne Edicioni e V te Festivalit Nerkombetar “Koko Fest”, ne Teatrin “A.Z. Çajupi” me shfaqjen “Roberto Zucco” nen regji te regjisorit Qendrim Rijani, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
16. Me 15 Shtator 2018 jepet repriza e shfaqjes “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren
17. Me 21 Shtator 2018 jeper repriza e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”- Prizren.
18. Me 25 Shtator 2018,jepet repriza e shfaqjes “Ata Qe Ikin”- Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Per nder te 140 vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit.
19. Me 28 Shtator 2018, Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren merr pjese ne Festivalin Nderkombetar te Teatrit ne Tirane me shfaqje “Ata qe Ikin” nen regji te regjisorit Kushtrim Bekteshi, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Ne kete festival juria e vlerson shfaqjen me 2 çmime si ne vijim Çmimi Aktorja e re me e mire e mori aktorja nga Prizreni Hajat Toçilla dhe Çmimi per skenografinë me te mire e mori skenografi Mentor Berisha, si dhe kjo shfaqje u nominua edhe per 5 nominime.
20. Me 16 Tetor 2018 jepet repriza e shfaqjes “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren
21. Me 18 Tetor 2018 jep shfaqjen “Kukulla” nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren, si shfaqej mysafyre ne Teatrin e qytetit te Gjilanit.
22. Me 20 Tetor 2018 jeper repriza e shfaqjes “Roberto Zucco” Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
23. Me 25 Tetor 2018 jepet repriza e shfaqjes “Ata Qe Ikin”- Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren.
24. Me 26 Tetor 2018 Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren merr pjese ne “Festivalin e Teatrove ne Ferizaj” ne Ferizaj me shfaqje “Ata qe Ikin” nen regji te regjisorit Kushtrim Bekteshi, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit “Bekim Fehmiu”-Prizren. Ne kete festival u



- vleresuar me dy çmime Çmimi Kostumografia me e mire e mori kostumografja Samka Ferri dhe per skenografine me te mire te cilen e mori skenografi Mentor Berisha.
25. Me 06 Nentor 2018 Teatri I Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren merr pjese ne " Festivalin e Teatrit "Otello" Gostivar 2018" ne Gostivar me shfaqje "Ata qe Ikin" nen regji te regjisorit Kushtrim Bekteshi, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren.
  26. Me 08 Nentor 2018 jep shfaqjen "Kukulla" nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren, si shfaqej mysafyre ne Teatrin "Adriana Abdullahu" Ferizaj.
  27. Me 12. Nentor 2018 jepet repriza e shfaqjes "Kukulla" nen regji te regjisorit Prizrenas Kaltrim Balaj, Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren
  28. Me 23 Nentor 2018 ne Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren ne kuader te bashkepunimit dhe shkembimit te shfaqjeve dhe pervojave teatrore vjen shfaqja myasafyre "Psikozë" e regjisorit Fatos Berisha nga Teatri "Adriana Abdullahu" nga Ferizaj .
  29. Me 24 Nentor 2018 jeper repriza e shfaqjes "Roberto Zucco" Prodhim nga Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"-Prizren.
  30. Shfaqja per femije Premiera "Pinokio" nën regji të regjisoresh Milihate Qena, e cila eshte shfaqja e pare e ketij lloj e prodhuar ndonjehere nga Teatri i Qytetit te Prizrenit "Bekim Fehmiu"- Prizren, datë 10.12.2018 ora 20:00
  31. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Emin Duraku" PZ Datë 12.12.2018 ora 11:20.
  32. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Emin Duraku" PZ Datë 12.12.2018 ora 15:30
  33. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. Lekë Dukagjini" PZ Datë 13.12.2018 ora 11:00
  34. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. Lekë Dukagjini" PZ Datë 13.12.2018 15:30
  35. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Lojola" PZ Datë 14.12.2018 ora 11:00
  36. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Motrat Qiriaz" PZ Datë 14.12.2018 ora 12:00
  37. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Motrat Qiriaz" PZ Datë 18.12.2018 ora 12:00
  38. Repriza e Shfaqjes "Pinoku" Datë 15.12.2018 ora 18:00.
  39. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Abdyl Frashëri" PZ Datë 17.12.2018 ora 10:00
  40. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Abdyl Frashëri" PZ Datë 17.12.2018 ora 14:00
  41. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Abdyl Frashëri" PZ Datë 18.12.2018 ora 10:00
  42. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Nazim Kokollari" Pz Datë 18.12.2018 ora 12:00
  43. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Mustafa Baku" Pz Datë 19.12.2018 ora 13:00
  44. Shfaqja për femije "Pinokio" për Sh.F. "Lidhja e Prizrenit" Pz Datë 19.12.2018 ora 13:00
  45. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Marif School" Pz Datë 19.12.2018 ora 12:00
  46. Shfaqja per femije "Pinokio" për Qerdhen "Yllka" Pz Datë 20.12.2018 ora 10:30
  47. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Fadil Hisari" Pz Datë 21.12.2018 ora 10:30
  48. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh. F. "Mati Logoreci" Pz Datë 20.12.2018 ora 12:00
  49. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh. F. "Mati Logoreci" Pz Datë 21.12.2018 Ora 12:00
  50. Shfaqja per femije "Pinokio" për Sh.F. "Fatmir Berisha" Pz Datë 21.12.2018 ora 14:30
  51. Repriza e Shfaqjes "Pinoku" Datë 22.12.2018 ora 18:00.

### **Aktivitetet e organizuara në Shtëpinë e Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren, gjatë vitit 2018**

1. Lëvizja Vetëvendosje - Prizren, datë 19.01.2018
2. Shkolla Filllore "Lojola" - Prizren, datë 16.02.2018.
3. Kopshti "Ardhmëria" - Prizren, datë 14.02.2018.
4. Sabrina Karahoda (Fëmijët me Autizëm) – Prizren, datë me 02.04.2018.
5. IEAPP "Perspektiva" - Prizren, datë 03.03.2018.
6. SH.M.L.M "Luçiano Motroni" – Prizren, datë 23.03.2018.
7. Fondacioni "Lumbardhi" - Prizren, datë 25.03.2018.

8. Hidroregjioni Jugor- Prizren, datë 22.03.2018
9. OJQ "Durmish Asllano"- Prizren, datë 07.04.2018
10. OJQ "Durmish Asllano"- Prizren, datë 15.04.2018.
11. OJQ "Foleja"- Prizren, datë 15.04.2018.
12. OJQ "Dogryoll"- Prizren, datë 18.04.2018.
13. Enkel Sulaj –Tiranë, datë 13.05.2018.
14. NDI- Prishtinë (Nacional Demokratik Institut), datë 13.05.2018.
15. OJQ "Sharrski Behar"- Prizren, datë 12.05.2018.
16. KDTP- Prizren, datë 13.05.2018.
17. Kopshti Parafillor "Ylberi" – Prizren, datë 31.05.2018.
18. Erza Xheladini – Prizren, datë 19.05.2018.
19. OJQ "Novi Koncept"- Prizren, datë atë 21.05.2018.
20. Kopshti "Harea" – Prizren, datë 27.05.2018.
21. OJQ "Rumeli TTSD"- Prizren, datë 17 dhe 18. 06.2018.
22. Kopshti " Papatie Kamomile"- Prizren, datë 26.06.2018.
23. Teatri Amator "Drama Shqipe" – Prizren, datë 07.06.2018
24. Qerdhja "London Eye"- Prizren, datë 11.06.2018.
25. Teatri Amator "Drama Shqipe" – Prizren, datë 20.06.2018.
26. Lëvizja "Vetëvendosje"- Prizren, datë 10.06.2018.
27. Qerdhja "Bletëza"- Prizren, datë 18.06.2018
28. Dora Weiss-Prizren, datë 29.07.2018
29. Shpresa Shiqeca, Ekspozitë personale – Prizren, datë 28.07.2018
30. OJQ "TGEE"- Prizren, datë 30.07.2018.
31. Doku Fest – Prizren, mbajtur nga data 03.08.2018 deri me datë 11.08.2018
32. Akademi përkujtimore, datë 15.08.2018.
33. Levizja "Vetëvendosje"- Prizren, datë 27.09.2018
34. OJQ "Rumeli TTSD"- Prizren, datë 25.09.2018.
35. OJQ "Sharrski Behar", datë 03.10.2018
36. Fëmijët nga Dibra koncert, datë 05.10.2018.
37. Kuvendi Komunal Akademi Kushtuar "Demonstratave të 1968" - datë 10.12.2018
38. Shfaqje për fëmij nga Zani Arapi – Prizren, datë 10.10.2018.
39. TKSD " Filizler" –Prizren, datë , 08,09.10.2018.
40. SHPK "ABI" – Prizren për Teatrin Turk nga Shkupi, datë 16.11.2018.
41. Iballe Dakaj – Prizren, datë 31.10.2018.
42. Kopshti "Perspektiva" – Prizren, datë 25.11.2018.
43. SHKA "Agimi", Koncert - datë 14 dhe 15.11.2018.
44. Biblioteka e Prizrenit, datë 27.12.2018.
45. A.K.V "Lidhja e Prizrenit" – Koncert, datë14.12.2018
46. Biblioteka e Prizrenit - Përvjetori "Dita e Bibliotekës" - datë21.12.2018
47. Kuvendi Komunal "Laureatët e Vitit 2018" - datë 21.12.2018
48. OJQ "Nevo Koncepti" Koncert - datë 22.12.2018
49. Liman Asllani Koncert Humanitar datë 24.12.2018
50. SH.K.A " Agimi" Koncert, datë 28.12.2018
51. "Shoqata Kibernetikes të Kosovës" - datë 30.12.2018

## BIBLIOTEKA E QYTETIT Aktivitetet gjatë vitit 2018

Biblioteka e qytetit të Prizrenit si njëra ndër bibliotekat më të vjetra në Kosovë, është në shërbim të lexuesve të saj, duke filluar nga parashkolloret e deri tek pensionistet, si dhe në shërbim të të gjitha përkatësive etnike të cilat jetojnë dhe veprojnë në Prizren. Shërbimet e saj fillojnë në ora 8.00-19.00, ndërsa ditën e shtunë punon vetëm ndërrimi i parë. Edhe këtë vit, biblioteka është munduar ta përmbyll me punë të rregullt këtë vit, duke qenë në shërbim të shfrytëzuesve të bibliotekës, si dhe me aktivitete të ndryshme punuese.



Çaste nga aktivitetet e bibliotekës

### Në këtë raport janë paraqitur:

- Sektorët e punës të bibliotekës
- Shërbimet e ofruara për sektorë
- Aktivitetet e mbajtura
- Rrjeti bibliotekar
- Struktura organizative e punëtorëve të bibliotekës
- Furnizimet dhe pasurimi i fondit librar
- Vështirësitë e bibliotekës

### 1. Sektorët e bibliotekës

Në bibliotekë për momentin funksionojnë këto sektorë punues:

- Sektori i përpunimit dhe katalogimit,
- Sektori i hulumtimit dhe zhvillimit,
- Sektori i fëmijëve,
- Sektori i të rriturve,
- Sektori i leximit dhe i internetit,
- Këndi Amerikan,
- Liberbusi / Infobusi ( si bibliotekë lëvizëse që frekuenton 22 fshatra të ndryshme),
- Financat dhe Administrata



### 2. Shërbimet e ofruara

	Sektorët	Nr. i anëtarëve	Nr.i libra.të lex.	Sherbime tjera (kompj. Internet, revista, gazeta)
1.	Sektori i fëmijëve	794	11401	1074revista
2.	Sektori i të rriturve	845	8489	
3.	Salla e leximit	236	3507	1264 gazet. 1843 revist. 17613 sherb. tj.
4.	Libërbusi	486	2936	
5.	Këndi Amerikan		4097	22706 shfrytzes , 2363 revista, 6105 kompjuter, 272 aktivitete, 82 ligjerata
6.	Biblioteka Zym	133	861	352 gazeta
7.	Biblioteka Gjonaj	233	1636	
	Gjithsejtë	2727	32930	272 deri tash - aktivitete, 82- ligjerata 5280- revista; 1616- gazeta

### 3. Disa nga aktivitetet më të rëndësishme janë :

- Movi time ( aktivitet javor 1x ne jave Sahar Zajnab ETA)( 3.1.2018-)
- English clas ( 2x ne javë) – (3.01.2018)
- Englidsh cours ( 2x ne jave )
- Trajnimi i tri kendeve amerikane ( Prishtin . Mitrovic , Prizren )( 10.01.2018)
- Vinter camp ( me nacionalitete te ndryshme )( 11.01.2018)
- Dita Luter Kingut- student dhe vullnetar kanë punuar punime të ndryshme me ide të ndryshme për Luter Kingun ( 17.01.2018)
- Vebinari ( 19.01.2018)
- LMT Zvicrane per projektet bashkepunuese ( 29.01.2018 )
- Fuqizimi i grave në vendim-marrje- pjesmarrëse ishin 50 gra udhëheqëse të sektoreve të ndryshme punuese te rajonit te Prizrenit ( 8.2.2018)
- Ditëlindja e presidentit Linkoln- ky aktivitet është mbajtur nga prof. Stanley McGohey dhe vullnetaret e kendit dhe bibliotekës (12.02.2018).
- Nxënësit e Gjinnazit Loyolla , së bashku me prof. Luljeta Hoxha , kishin projektin „barazia gjinore” ( 14.02.2018)
- Me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë, filluam me çerdhet, vazhduam me Ekspoziten e 10 vjetorit të Pavarësisë, -Reportazhin 10 vite Pavarësi, Ora letrare; Konkursi letrar me shkollat e mesme të Prizrenit për çmimin e Pavarësisë ku u zgjodhën tri çmimet e para si dhe u shpërblyen 10 nxënës për 10 vjetorin e Pavarësisë; Pastaj grupi prej 50 vullnetarve u nisen për Kala nga ku edhe u lëshuan balonat si element i Pavarësisë, 16.02.2018
- **Fuqizimi i vajzave te reja** trajnim 5 ditor- ku morën pjesë 30 vajze te cilat hulumtonin tregun e punës në profesione të ndryshme - ku ligjerues ishin : Sinan Gashi nga Enti i punsimit , Adelina Hasani nga Femaktiv, Bujar Bilurdagi, Zejgjane Celina nga SHZAP, Sahar Jawadi prof. Amerikane. Në permbyllje te projektit u vizituan bizneset private te cilat udhehiqen nga femra te suksesshme . Fabrika e prodhimit te fruteve „ Fruti " dhe menagjerja e saj Rita Malsori si dhe fabrika e prodhimit te shamponeve „ Er-Abi " dhe menagjerja e saj Ymrane Fusha ( 23- 24-25-26-27..01.2018)
- **Mësimi i gjuhës përmes lojës**- aktivitet i rregullt javor ku grupi i vullnetarve të gjuhës angleze i mësojnë të interesuarve gjuhën angleze përmes lojes
- **Printimi 3D me të rinjët**- aktivitet i rregullt javor ku të rinjët aftësohen për përdorim të printerit 3D si dhe krijimin e formave të ndryshme atraktive



- **Akrivitet i Festave të Marsit** me nxënësit e SHMM si dhe me nxënësit e Gjinnazit „ Remzi Ademaj. Po ashtu për të gjithë mësimdhënësit që erdhën në bibliotek me datën 7 mars si dhe për të gjitha nënat me datën 8 mars i u dhuruan dhurata simbolike ( 7.03.2018)
- Trajnim dy ditor për puntëoret e këndeve në Gjakovë ( 8- 9 .03.2018)
- Game day – aktivitet i rregullt javor 3x ne jave
- Ec ma ndryshe – për vetdijsimin e qytetarve ( 12 .03 2018 )
- Artizanatet në qytetin e Prizrenit aktivitet 5 ditore me 50 nxënës të shkolles ekonomike - ku u vizituan më shumë se 20 artizanate të vjetra duke filluar nga qyteti i Prizrenit e për të vazhduar me pjesen e Opojes dhe Hasit ( 20.03 .2018- 30.03.2018)
- Dita botërore e poezisë – në shkollën „ Xhevat Berisha “ ( 21.03.2018 )
- Alen Bery – Media literari education( 27.03.2018 )
- Aktiviteti argëtues me fëmijë- aktivitet i rregullt javor me fëmijet e ciklit të ulët përmes vullnetarëve dhe prof. Amerikan
- Alen Bery – Media literari public servis PSA( 27.03.2018 )
- Infosesion – education USA – aktiviteti i rregullt mujor nga Qendra AAC ( 5.04.2018)
- Alen Bery – PSA vazhdim( 10.04.2018),

### Java e bibliotekës ( 11.04.2018)

- **Trajnimi tre ditor** i organizuar nga biblioteka jonë për të gjithë punëtorët e bibliotekave të Kosovës , ku ligjerues ishin prof. amerikan , nga BE , nga Shqipëria , Mali i Zi etj .Pjesëmarrës ishin 100 punëtor nga të gjitha bibliotekat e Kosovës .Fillimisht pjesëmarrësit i përshëndeti kryetari Mytahir Haskukaj , drejtori i kulturës Ehat Oreshka , drejtori i bibliotekës Kombëtare Fazli Gajraku . Pastaj vazhduam me ligjerata dr. Robert Montoya , projekti ERASMUS Bukuri e Haliti , Reinida Feto, Sahadete Sadikaj, Ramize Bajraktari, Brunilda Tahiri, ACP, ACPz.. ( 11-12-13.04.2018)
- Alen Bery – Media reportazh ( 19.04.2018 )
- **Dita e Tokës 22 Prillit** , u organizua një aktivitet në Qendren Burimore „ Nënë Tereza " pastrim , mbjellje të luleve dhe fidaneve . Pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e Ambasades Amerikane , stafi i bibliotekës , vullnetarët , nxënësit e shkollës etj. Qëllimi ishte sensibilizimi i të rinjve për ruajtjen e ambientit . Këtë vit Kuvendi Komunal i Prizrenit solli lulet dhe fidanet për mbjellje . (20.04.2018)
- **Njoftim për Bursën Fulbright-** Remzie Potoku (20.04.2018)
- Në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit u organizua aktiviteti me rastin e **23 prillit** –



Çaste nga aktivitetet e bibliotekës me fëmijë.



Çaste nga aktivitetet e bibliotekës

**Ditës së librit** ku nxenesit e të gjitha shkollave morën pjesë.

- Fillimisht u vizituan vendet e librave – në Bibliotekën tonë ku nxënësit u njohën me të gjitha sektoret punuese të bibliotekës
- si dhe me bibliotekën e Bashkësis Islame ku gjendet librat e vjetra dhe dorëshkrimet e rralla
- Pastaj nxënësit kaluan në hapsira të hapura ku edhe përgaditen eset më të mira për librin. Të gjithë nxënësit pjesmarrës u shpërblyen me libra , ndërsa eset më të mira do të shpërblehen pas vlersimit nga komisioni.

- Me rastin e **Dites se librit** u bë promovimi i librit të fundit të **Jusuf Buxhovit – Dushkaja, 23.04.2018**
- **Fëmijet nga qendra “London Eye”** – qdo javë i sjellin fëmijet në mësim dhe aktivitete të ndryshme ( 24-25-30.04.2018)
- **Nxenesit e shkolles Mehmet Akif** – aktivitete në bibliotek ( 24.04.2018)
- **Punime dore me fëmijë**- aktivitet i rregullt javor ku qdo javë punohen punime të ndryshme me fëmijë varësisht nga tematika dhe interesimi
- **Free english conversation** – 2 x në javë Alberita ( 24.04.2018 )
- **Nxenesit e shkolles Lek Dukagjini** – komentimi i storjes – tregimit dhe vizit bibliotekes ( 27.04.2018)
- **Vebinari** – American English live Teacher development seria II (2.05.2018)
- **Nxenesit e shkolles Haziz Tolaj** – Komentimi i lektyrave në bibliotekë dhe komentimi i tregimeve audiovizuale ( 3.5.2018)
- **Conversation** – ETA Sahar Zinab me student ( 3. .5.2018)
- **Testimi littlebitsave** (qarqeve elektrike)- përmes punëtorit të TI nxënës dhe student kanë mundësi të njihen me paisjet më të reja të teknologjis informative si dhe përdorimin e tyre ( 4.5.2018)
- **Krijimi reklamave vetedijesuese digjitale** – njoftim ligjeratë- prof amerikan Alan Berry / Stanley McGohey – ( 2,5,2918)
- **Prezantimi për mundësinë e studimeve në Amerikë**- Rrezarta Shabani – American Advasing Center
- **Krijimi reklamave vetedijesuese digjitale** – ushtrim/testim- Alan Berry / Stanley McGohey
- **Aktivitet me littlebits** me nxenes- aktivitet i rregullt javor ( 22.5.2018 )
- **Webinari** me student – vazhdim
- **Krijimi reklamave vetedijesuese digjitale** – inçizimi në teren- Alan Berry / Stanley McGohey
- **Krijimi i personalitetit**- ligjerat nga Sahar Zainab prof. amerikane. ( 8- 10 .5.2018)
- Aktiviteti „ **Involvimi i nënave të fëmijve me nevoja të veqanta** ” ku morën pjesë nënat e fëmijve nga : Qendra Burimore „ Nënë Tereza ” , „ Pema ” , Autizmi , „ Lef Nosi ” Caritasi, Sindrom Down, Hendikosi etj. Pjesmarrëset patën rast të bashkëbisedojnë me dr. Naim Fanaj – psikiatër , Dea Karabagjak – dietologe , Hajrije Shala – psikologe klinike etj.( 15.05.2018)
- Aktivitet me fëmijet nga shkolla “Loyola” – ( 21-23.05.2018 )
- Diskutim i lirë me studentë në gjuhën angleze – Sahar Zainab ( 29.05.2018)

- Lexim në bibliotekë me shkrimtaren Gonca Ozmen nga Turqia
- Aktivitet me fëmijet nga qendra “Cambridge” ( 1.6.2018 )
- Me rastin e 1 Qershorit sot u mbajt aktiviteti me fëmij të kopshteve: „ Perspektive ” „, Perspektiva T” „, „ Ne i duam femijet ” „, Hareja ” „, Papatia ”
- Nxënësit krijues nga të gjitha shkollat u munduan të krijojnë punimet më të bukura në prozë dhe në poezi në kuadër të konkursit që u organizua për aktivitetin tradicional „ Java e Remzi Ademaj ”. Punimet më të mira do të shpërblehen.
- Kujdesi i vetës dhe meditimi- ligjerat Sahar Zainab ( 5.6.2018)
- Krijimi i reklamave vetedijuese digjitale – përmbyllja e videove- Alan Berry / Stanley McGohey
- Promovimi i librit “Antologji e dramës bashkëkohore nga Kosova” e Çagdas Kosova Oynlari Seçkisi], i botuar siçjet në Turqi, marrin pjesë, botuesi i mirënjohur turk Turhan Yılmaz Öğüt, drejtor i shtëpisë botuese Mitos Boyut, Mehmet Fatih Ölekli, editor në Mitos Boyut dhe Dr. Senem Cevher, përkthyes e antologjisë dhe studiuese e teatrit.
- Aktivitet me fëmijet nga çerdhja “Hareja”- Komuniteti boshnjak ( 6.6.2018 )
- Aktivitet me fëmijet nga shkolla “Nefit Jusufi” nga fshati Skorobisht .6.2018 )
- Me rastin e 140 vjetorit të Lidhjes Shqipëtare të Prizrenit , u mbajt ekspozita „ Kujtesa e Lidhjes së Prizrenit ” . Po ashtu nga Biblioteka Kombëtare ishte përgaditur edhe Katalogu „ Kujtesa e Lidhjes së Prizrenit ” si dhe Ekspozita me gravura .
- Bibliografia e krijuesve 1912-1999
- Ditët e Diaspores ( 27.7.2018)
- Ekspozita Prizreni I vjeter
- Ora Letrare
- Librat dhe materialet promovuese për mërgimtar
- 4 korriku – Dita e pavarësis së SHBA – ekspozitë dhe punime në ambiente të hapura , ku tri vendet e para janë shpërblyer ( 4.7.2018 )
- Ndertimi i tolerancës në mes të komuniteteve përmes artit rrugor – prof. Isac Yawow ( 26.7.2018 )
- Turizmi në Prizren ( 1.8.2018 – 12.8.2018 ) ku kanë qenë 15 vullnetarë të angazhuar në bashkëpunim me Docufest-in dhe Ambasaden Amerikane ( 1.8-12.8.2018)
- Java e leximit. ku kanë marrë pjesë 50 fëmijë nga të gjitha nacionalitetet që jetojnë në Prizren , dhe qëdo ditë nxënësit kanë patur mundësi leximi dhe krijimi në hapsira të hapura me qëllim të sensibilizimit të leximit dhe rëndësisë së librit , një ditë ishim në Gjakovë me fëmijë në qendrën Bonevet , Teater , Bibliotekë (13.8.2018 -17 .8.2018)
- Lirë fetare të shprehurit – Debra Mason - Ambasada Amerikane ( 4.9.2018 )
- Takim me qytetaret e vjetër për botimet e vjetra ( 5.9.2018 )
- 11 shtator – rikujtim i ngjarjeve – me vullnetarë ( 11.9.2018)
- Nenshkrimi i grantit për projektet e 5 komunave ( 18.9.2018 )
- Projekti për vetdijësimin e të rinjëve në Lubinjë të Eperme dhe të Poshtme ( 21.9.2018 )
- Projekti për vetdijësimin e të rinjëve në Nashec dhe të komuniteti rom ( 25.9.2018 )
- Projekti për vetdijësimin e të rinjëve në Piran dhe Krushe të vogël ( 26.9.2018 )
- Projekti për vetdijësimin e të rinjëve në Mamush dhe Medvec ( 27.9.2018 )
- Projekti për vetdijësimin e të rinjëve në Korish dhe Velezh ( 28.0.2018)
- Fillon praktika e nx. Te shkolles ekonomike ( 4.10.2018 )
- Librat e vjetra në bibliotekën e Universitetit të Prizrenit ( 9.10.2018 )
- Librat e vjetra në Suharek ( 10.10.2018 )
- Vizitë e kopshtit Nena Kabrini dhe sinkronizimi i tregimeve për fëmijë përmes punimit të figurave ( 12.10 .2018 )
- Java e sportit ( 15- 16-17-18-19.10.2018 )
- Promovimi i librit Lulevargu i Abdullah Thaqit ( 26.10.2018 )
- Hapja e konkursit letrar ( 26.10.2018 )
- Projekti „ Zbatimi i ligjit në biznes “ në Gjykatë komunale ( 29.10.2018)
- Nx. E shkolles „ Mustafa Baku “ në bibliotekë ( 29.10.2018 )
- Projekti „ Zbatimi i ligjit në biznes “ në ATK – ligjerat ( 30.10.2018 )

- Projekti „ Zbatimi i ligjit ne biznes “ ne drejtorin e financave ( 31.10.2018 )
- Halloveni me nxenes dhe student ( 31.10.2018)
- Projekti „ Zbatimi i ligjit ne biznes “ ne Fabriken Kosova – Pack ( 1.11.2018 )
- Workshop per Projektin „ Zbatimi i ligjit ne biznes “ ( 2.11.2018 )
- Story telling – Brooke Leach Grable – ELF ( 7.11- 12.12.2018 )
- Java e edukimit – Drita Sylja AAC – ( 13.11.2018 )
- Panairi i librit ne Tiran – vizit e puntorve te bibliotekes ( 17.11.2018)
- Projekti „ Sfidat e te rinjeve perball Siguris ‘ ‘ – SHMMjeksis dhe e ekonomis ( 19.11.2018 )
- Projekti „ Sfidat e te rinjeve perball Siguris ‘ ‘ ne Medrese dhe Gjinnaz ( 20.11.2018 )
- Projekti „ Sfidat e te rinjeve perball Siguris ‘ ‘ ne SHM Teknike ( 21.11.2018 )
- Dita e falenderimeve me student dhe vullnetar , me Peace Corps ( 22.11.2018 )
- Projekti „ Sfidat e te rinjeve perball Siguris ‘ ‘ – permyllja dhe workshopi ( 26.11.2018 )
- Dream Builder – projekt me 13 kurse nje her ne jav , ku marrin pjes 30 femra prej moshes 18-50 vjeqare ( 26.11.2018 – 26 .01.2019)
- Printimi me laps 3D si dhe me printer 3 D ( 27.11.2018 )
- Aktivitetet per festat e Nentorit:
  - Shperblimi i fituesve te konkursit letrar , fituesit e konkursit per ditën e librit ,
  - ekspozita e abetares , si dhe
  - program festiv me shkollat e mesme ( 27.11.2018 )
- Aktivitete me nxenes te shkollave speciale 26-28.12.2018 )
- Aktivitetet per festat e fundvitit ( 24-28.12.2018 )
- Dita e bibliotekes ( 21.12.2018 )
- Ekspozita e Skenderbeut ( 21.12.2018 )
- Ekspozita e librit 2018 ( 21.12.2018 )
- Zgjedhja e fituesve te vitit ( 21.12.2018 )
- Promovimi i librit te fundit te bibliotekes ( 21.12.2018 )

### Aktivitetet e rregullta javore :

- „Tofel for ewryone” , kurs i avancuar i mbajtur ne menyre te rregullt ne Kendin Amerikan nga professor amerikan
- „ Game day “aktivitet ku mesimet realizohen permes lojes
- „ Conversation- bashkëbisedim me student dhe nxënës për mësimin e gjuhës angleze ”
- „ Aktivitet me femij të klasave të ndryshme “me vullnetar të ndryshëm
- Aktivitete me vullnetaret e Kendit Amerikan me prof. amerikan
- „ Movi time” aktivitet me shikim te filmave dhe materialeve te ndryshme teknike
- Kreativ wraiting( të shkruar kreativ ) ku nxënësit testojn veten ne te shkruar kreativ
- Vebinari – aktivitet i rregullt me arsimtar te shkollave te ndryshme te Prizrenit .
- „Riding “- leximi i materialeve te ndryshme si dhe i romaneve me te reja
- Viziten e fëmijve parashkollor dhe shkollor në bibliotekë në bibliotek



Nga aktiviteti javor i bibliotekës



- Ketnet – aktivitet i rregullt me arsimtar te gjuhes angleze te shkollave te ndryshme
- Aktivitet me vullnetar te Kendit amerikan
- English our – 3 her ne jave
- English klas – 2 her ne jav
- Intervistat e rregullta me medijat e hapura si RTK , KTV, TRV 21 , TV Opinion , TV Besa, TVPZ,

#### 4. Rrjeti bibliotekar

- Biblioteka jonë në mbikqyrje profesionale ka edhe bibliotekat e komunave që veprojnë në rajonin e Prizrenit si dhe bibliotekat e degëve dhe shkollave :
- Biblioteka komunale në Sharr (Dragash):-me degët në Brezne , Bresana , Brod ( goran ) , Krushevo( goran) , Bellobrad
- Biblioteka komunale në Therandë (Saharekë):- me degët Nishor , Mushtisht
- Biblioteka komunale në Malishevë:- me degën në Kijevë , dhe së shpejti në Bajë
- Biblioteka komunale në Mamushë :
- Degët tjera janë në : Zym, Gjonaj , Velezh (pa punëtor), Lubizhdë (pa punëtor), Zhur (pa punëtor),

#### Furnizimi i bibliotekës me tituj të rinj

- Gjatë këtij viti biblioteka është furnizuar me 397 ekz. të blerë në Panair si dhe me 721 libra te dhuruara .
- Gjatë këtij viti janë ndihmuar pos bibliotekave në degë , bibliotekave komunale po ashtu edhe bibliotekat e shkollave, (Bib. Ne deg 35 ekz; Motrat Qiriazia – 97 ekz; Pllanjane 230; Lubinje 189; Mamush 381 ekzemplarë).

#### 5. Vështirësitë e bibliotekës

Edhe gjatë këtij viti, biblioteka ndër komunale e Prizrenit vazhdoi punën e saj me një përkushtim të madh të stafit duke i pas parasysh problemet e shumta me të cilat u përball stafi i bibliotekës , të cilat gjatë këtij viti ishin të shumta si mungesa e hapësirës dhe fondit të ndarë për veprimtarin e bibliotekës , mungesa e pastruesit te bibliotekës, mungesa e ujit te pijshëm, etj.

#### 6. Synimet

Bazuar në vështirësitë me të cilat përballlet biblioteka, fillimisht do të synojmë tejkalimin e këtyre vështirësive duke zgjidhur problemin e hapësirave të bibliotekës, shtimin e fondeve për pasurimin e bibliotekës duke hulumtuar edhe donacione të ndryshme, po ashtu edhe shtimin e stafit të bibliotekës si dhe organizimin e trajnimeve profesionale



Çaste nga aktivitetet e bibliotekës



Fëmijët në këndin amerikan

me staf të bibliotekës si dhe bibliotekave në degë. Po ashtu planifikohet edhe zgjerimi i rrjetit bibliotekar si dhe riaktivizimi i bibliotekave dhe hapja e bibliotekave të reja në vende ku nuk ka bibliotekë.

Me respekt,  
Drejtori, Ehat Oreshka